

PHILIPS

AVENT

SCD730, SCD731
SCD733, SCD734
SCD735



Manuali i përdorimit

Tabela e përmbajtjes

Informacion i rëndësishëm sigurie	3
E RËNDËSISHME.....	3
Hyrje	6
Ekrani i njësisë së prindit (Fig. 1)	6
Përgatitja për përdorim	7
Njësia e bebes	7
Njësia e prindit.....	7
Përdorimi i monitorit të bebes	7
Pozicionimi i monitorit të bebes	7
Lidhja e njësisë së prindit dhe njësisë së bebes.....	8
Funksionet dhe reagimet në njësinë e bebes	9
Drita e natës	9
Funksioni i ninullës.....	9
Projektori	10
Thirrja për njësinë e prindit	10
Drita e statusit të baterisë.....	10
Funksionet dhe reagimet në njësinë e prindit	11
Menyja e qetësimit	11
Volumi	13
Funksioni i të folurës	14
Modaliteti i errësimit për natën	14
Sinjalizimi i nivelit të ulët të baterisë së njësisë së bebes	14
Treguesit e gjendjes së baterisë	15
Menyja e njësisë së prindit	15
Navigimi në meny	15
Ndjeshmëria	16
Modaliteti Eco Max.....	17
Kohëmatësi i ushqimit	18
Temperatura e dhomës	19
Sinjalizimi për të qarat.....	20
Ora.....	20
Gjuha	20
Kycja e butonave	21
Informacione mjedisore	21
Riciklimi	21
Mbështetja	21

Informacion i rëndësishëm sigurie

Lexojeni me kujdes këtë informacion të rëndësishëm përpara përdorimit të pajisjes dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

E RËNDËSISHME

Ky monitor foshnje synohet për përdorim ndihmës. Nuk zëvendëson mbikëqyrjen e përgjegjshme dhe të duhur të të rriturit dhe nuk duhet përdorur me qëllime të tilla.

Mos e lini kurrë foshnjën vetëm në shtëpi. Sigurohuni gjithnjë që të jetë dikush i pranishëm për t'u kujdesur për foshnjën dhe për t'iu përgjigjur nevojave të saj.

Klauzolë

Vini re se këtë monitor foshnje e përdorni me përgjegjësinë tuaj. Koninklijke Philips N.V. dhe filialet e saj nuk janë përgjegjëse për funksionimin e këtij monitori foshnjash ose përdorimin e tij nga ana juaj dhe për këtë arsye nuk marrin përsipër asnjë detyrim në lidhje me përdorimin e këtij monitori foshnjash nga ana juaj.

Rrezik

- Mos zhytni kurrë asnjë pjesë të monitorit të foshnjës në ujë apo në lëngje të tjera. Mos e vini pajisjen aty ku mund të pikohet apo laget nga uji apo lëngje të tjera. Mos e përdorni monitorin e foshnjës në vende me lagështirë apo pranë ujit.
- Mos i vendosni kurrë sende përsipër monitorit të foshnjës dhe mos e mbulonit. Mos ia bllokoni vrimat e mundshme të ajrimit. Instaloheni në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Paralajmërim

- Kablo e gjatë. Rrezik mbytjeje!
- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar përkon me voltazhin e linjës lokale.
- Përdorni vetëm ushqyesin e dhënë.
 - Modeli: S005Bxy0600050
 - Vlerësimi: Hyrja: 100-240 V~ 50/60 Hz, 0,15 A
Dalja: 6,0 V === 0,5 A, 3 W
 - xy=NV (spinë për BE) ose xy=NB (spinë për MB)
 - Efikasiteti mesatar aktiv: 74,38%
 - Konsumi i energjisë pa ngarkesë (W): 0.1 W NIVELI VI
- Mos i modifikoni apo prisni pjesët e ushqyesit dhe të kordonit të tij, pasi kjo shkakton situata të rrezikshme.
- Nëse ushqyesi është i dëmtuar, ndërrojeni gjithnjë me një tip origjinal për të shmangur rrezikun.

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore, apo që kanë mungesë përvojë dhe njohurish vetëm nëse ata mbikëqyrën ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët pa qenë të mbikëqyrur.
- Mbrojeni kordonin elektrik nga shkelja apo përkulja, sidomos te spinat dhe pika nga ku dalin nga pajisja.
- Sigurohuni ta vendosni monitorin e foshnjës në mënyrë të atillë që kordoni të mos pengojë dyert apo vendkalimet. Nëse e vendosni monitorin e foshnjës në tryezë apo në mobilie të ulët, mos e lini kordonin elektrik të varet nga tryeza apo mobilia. Sigurohuni që kordoni të mos rrijë në dysHEME ku përbën rrezik pengimi.
- Mbajini materialet e paketimit (qese plastike, tako kartoni etj.) larg vendeve ku mund të arrihen nga fëmijët, pasi nuk janë lodra.
- Për të parandaluar elektroshokun, mos e hapni kasën e njësisë së foshnjës apo të prindit.

Udhëzimet e sigurisë për baterinë

- Përdoreni këtë produkt vetëm për qëllimin e synuar. Lexojeni këtë informacion me kujdes përpara se të përdorni produktin dhe bateritë e aksesorët e tij, dhe ruajeni për referencë në të ardhmen. Keqpërdorimi mund të shkaktojë rreziqe dhe lëndime të rënda. Aksesorët e ofruar mund të ndryshojnë për produkte të ndryshme.
- Karikojeni, përdoreni dhe ruajeni produktin në temperaturë midis 0 °C dhe 40 °C.
- Sigurohuni që të përdorni bateritë e mëposhtme:
 - Njësia e foshnjës: Bateria 1,5V R6 AA alkaline të parikarikueshme ose bateri të rikarikueshme të karikuara 1,2 V AA HR6. Karikoni bateritë e rikarikueshme në një karikues të veçantë për bateri.
 - Njësia e prindit: Philips 130 AAHC 1,2 V, 1300 mAh (SCD730/SCD731/SCD733); GP 180AAHC 1,2 V, 1800 mAh (SCD734/SCD735/SCD733).
 - Përdorni vetëm baterinë e rikarikueshme që vjen me njësinë e prindit.
 - Mos i rikarikoni bateritë e parikarikueshme në njësinë e prindit.
- Mbajini produktin dhe bateritë larg zjarrit dhe mos i ekspozoni drejtpërdrejt në dritën e diellit apo ndaj temperaturave të larta.
- Mbajini gjithnjë bateritë petë larg fëmijëve. Gëlltija e këtyre baterive mund të shkaktojë lëndim të rëndë deri dhe vdekje.
- Nëse produkti mbinxehet, lëshon erë, ndryshon ngjyrë ose nëse karikimi zgjat më shumë se zakonisht, ndërpriteni përdorimin dhe karikimin e produktit dhe kontaktoni me „Philips“.
- Mos i vendosni produktet dhe bateritë e tyre në furra me mikrovalë apo në vatra induksioni.
- Mos e hapni, modifikoni, shponi, dëmtoni apo çmontoni produktin apo baterinë për të parandaluar nxehjen e baterive apo çlirimin e substancave toksike ose të rrezikshme. Mos u krijoni lidhje të shkurtër, mos i mbikarikoni dhe mos i karikoni në pole të kundërta bateritë.

- Nëse bateritë dëmtohen apo pikojnë, shmangeni kontaktin me lëkurën ose sytë. Nëse ju ndodh diçka e tillë, shpëlahjini mirë me ujë dhe kërkonij kujdesin mjekësor.
- Kur punoni me bateritë, sigurohuni që t'i keni të thata duart, produktin dhe bateritë.
- Futni bateritë me polet + dhe - në drejtimin e treguar në folenë ose mbajtësin e baterive.
- Mos kombinoni marka ose lloje të ndryshme baterish, mos kombinoni bateri të reja me të përdorura dhe mos përdorni bateri me kode të ndryshme të datës.
- Hiqini bateritë nga produkti nëse nuk do ta përdorni për njëfarë kohe.
- Për të shmangur lidhjen e shkurtër të baterive pas heqjes, mos i lini kontaktet e tyre të takojnë sende metalike (p.sh. monedha, karfica, unaza). Mos i mbështillni bateritë me fletë alumini. Vendosjuni ngjitëse kontakteve të baterisë ose vëriini bateritë në qese plastike përpara se t'i hidhni.
- Mos i lini brenda produktit bateritë e shkarkuara njëpërdorimëshe.
- Bateritë e rikarikueshme kanë një numër të kufizuar ciklesh ngarkimi. Kohëzgjatja e baterisë dhe numri i cikleve të ngarkimit mund të ndryshojnë sipas përdorimit dhe cilësimeve.
- Mos e hapni produktin për të ndërruar baterinë e rikarikueshme.

Kujdes


- Mos e instaloni pajisjen pranë burimeve të nxehtësisë si p.sh. radiatorë, rezistenca, soba apo aparate të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që lëshojnë nxehtësi.
- Sigurohuni që t'i keni të thata duart kur përdorni ushqyes, spina dhe kordonin elektrik.
- Të gjitha shenjat e kërkuara mbi njësinë e foshnjës, të prindit dhe ushqyesit elektrik ndodhen në fund të njësisë së foshnjës, të prindit dhe ushqyesit elektrik.

Deklarata e konformitetit

Nëpërmjet këtij dokumenti, "PHILIPS Consumer Lifestyle B.V." deklaron se ky produkt është në pajtim me kërkesat thelbësore dhe dispozitat përkatëse të Direktivës 2014/53/BE. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të KE-së (DoC) ofrohet në internet te www.philips.com/support.

Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.



Hyrje

Shko te www.philips.com/welcome për të regjistruar produktin tuaj dhe për të lexuar manualin e detajuar të përdorimit.

Ekrani i njësisë së prindit (Fig. 1)

- 1 Treguesi i fuqisë së sinjalit
- 2 Treguesi Eco Max
- 3 Simboli i modalitetit të errësimit për natën
- 4 Treguesi i sinjalizimit për të qarar
- 5 Simboli i çaktivizimit të zërit
- 6 Treguesi i gjendjes së baterisë
- 7 Shigjeta e navigimit
- 8 Simboli i temperaturës
- 9 Treguesi i ndjeshmërisë së mikrofonit
- 10 Simboli i dritës së natës
- 11 Simboli i ninullës
- 12 Simboli i projektorit
- 13 Simboli i kohëmatësit ose përsëritjes së kohëmatësit
- 14 Ekrani i menysë së qetësimit

Përgatitja për përdorim

E RËNDËSISHME: Lexoni me kujdes informacionet e rëndësishme të sigurisë para se ta përdorni monitorin e bebes dhe mbajini për referencë në të ardhmen.

Njësia e bebes

Ne këshillojmë që ta përdorni njësinë e bebes të lidhur me rrjetin elektrik kryesor. Për të garantuar një rezervë automatike për energjinë në rast të ndërprerjes së rrjetit elektrik kryesor, futni katër bateri alkaline AA 1,5 V (nuk janë të përfshira).

Karikoni bateritë e rikarikueshme në një karikues të veçantë për bateri. Njësia e bebes nuk ka një funksion karikimi dhe bateritë e rikarikueshme shkarkohen ngadalë kur nuk janë në përdorim.

Njësia e prindit

Njësia e prindit punon me dy bateri të rikarikueshme që janë të përfshira me monitorin e bebes. Karikojeni njësinë e prindit përpara përdorimit për herë të parë dhe kur bateritë janë në nivel të ulët.

Kini parasysh se për modelin SCD730/SCD731/SCD733, duhet ta karikoni njësinë e prindit për 10 orë të plota për të pasur një kohë funksionimi me bateri për 18 orë. (Për modelin SCD734 dhe SCD735: koha e karikimit është 14 orë dhe koha e përdorimit është 25 orë.

Shënim: Kur filloni të përdorni monitorin e bebes, duhen 4 cikle karikimi dhe shkarkimi para se bateritë e rikarikueshme të arrijnë kapacitetin e tyre të plotë.

Përdorimi i monitorit të bebes

Pozicionimi i monitorit të bebes

Mbjajeni njësinë e bebes larg bebes. Asnjëherë mos e vendosni njësinë e bebes brenda shtratit të bebes ose koshit të bebes.

- Për shkak se kordoni i njësisë së bebes përbën një rrezik të mundshëm për mbytje, sigurohuni që njësia e bebes dhe kordoni i saj të jenë të paktën 1 metër/3,5 këmbë larg bebes.
- Për të parandaluar një tingull me ton të lartë nga një ose të dyja njësitë, sigurohuni që njësia e prindit të jetë të paktën 1 metër/3,5 këmbë larg njësisë së bebes.

Lidhja e njësisë së prindit dhe njësisë së bebes

- 1 Mbani të shtypur butonin \oplus në njësinë e bebes për 2 sekonda deri sa të aktivizohet drita e ndezjes.
- 2 Mbani të shtypur butonin \oplus në njësinë e prindit për 2 sekonda deri sa të ndizet ekrani. Drita te "link" (lidhja) në njësinë e prindit fillon të pulsojë në ngjyrë të kuqe dhe në ekran shfaqet mesazhi "I AM LINKING" (Po lidhem).

Kur njësia e prindit dhe njësia e bebes janë të lidhura, drita te "link" (lidhja) bëhet jeshile e fortë. Në ekran shfaqet treguesi i fuqisë së sinjalit dhe mesazhi "LINKED" (Lidhur).

Nëse nuk është vendosur një lidhje, do të shfaqet mesazhi "NOT LINKED" dhe njësia e prindit fillon të lëshojë sinjale bip.

Çfarë të bëni nëse nuk është vendosur një lidhje

- Nëse njësia e prindit është jashtë rrezes, vendoseni atë më afër njësisë së bebes, por jo më afër se 1 metër/3,5 këmbë.
- Nëse njësia e bebes ose e prindit është shumë afër, <2 m/6,5 ft larg nga një pajisje tjetër DECT (p.sh. telefon pa kablo), fikeni këtë pajisje ose largojeni njësinë nga kjo pajisje.
- Nëse njësia e bebes është e fikur, ndizeni atë.

Rrezja e funksionimit


- Rrezja e funksionimit është 330 metra/1000 këmbë në ambiente të jashtme dhe deri në 50 metra/150 këmbë në ambiente të brendshme.
- Rrezja e funksionimit për monitorin e bebes ndryshon në varësi të ambientit rrethues dhe faktorët që mund të shkaktojnë interferencë. Materialet e lagështa dhe të njoma shkaktojnë kaç shumë interferencë sa humbja e rrezes mund të shkojë deri në 100%. Për interferencën nga materialet e thata, shikoni tabelën më poshtë.

Materialet e thata	Trashësia e materialit	Humbja e rrezes
Dru, allçi, karton, xham (pa metale, tela ose plumb)	< 30 cm (12 in)	0-10%
Tullë, kompensatë	< 30 cm (12 in)	5-35%
Betonarme	< 30 cm (12 in)	30-100%
Grila ose shufra metalike	< 1 cm (0,4 in)	90-100%
Fletë metalike ose alumini	< 1 cm (0,4 in)	100%


Funksionet dhe reagimet në njësinë e bebes


Drita e natës


Drita e natës krijon një ndriçim të butë që e qetëson beben tuaj.

- 1 Shtypni butonin  në njësinë e bebes për ta ndezur ose fikur dritën e natës.


Funksioni i ninullës



- 1 Shtypni butonin  në njësinë e bebes për të luajtur ninullën e fundit të zgjedhur. Ninulla e zgjedhur përsëritet për kohën e caktuar.




- 2 Shtypni butonin  për të zgjedhur një ninullë tjetër nga lista.



- 3 Për të rregulluar nivelin e tingullit të ninullës, shtypni butonin e volumit + ose - në njësinë e bebes.



Shënim: Mund ta caktoni volumnin e altoparlantit në njësinë e bebes vetëm kur luhet një ninullë. Nëse e caktoni më të lartë volumnin për ninullën, tingulli do të jetë po ashtu më i lartë kur përdorni funksionin e të folurës në njësinë e prindit.

- 4 Për të ndaluar luajtjen e ninullës, shtypni butonin  në njësinë e bebes.

Projektori

Mund ta qetësoni beben tuaj me motive dritash me ngjyra që projektohen në tavan duke ndezur projektoren.

1 Shtypni butonin e ndezjes/fikjes së projektorit për të ndezur projektoren. Simboli i projektorit shfaqet në ekranin e njësisë së prindit.



2 Janë gjashtë motive të ndryshme. Motivi i parë shfaqet gradualisht me intensitet të plotë për 2 sekonda. Ai projektohet për 8 sekonda dhe më pas zbehet për 2 sekonda ndërkohë që shfaqet gradualisht motivi tjetër. Çdo motiv projektohet për 10 sekonda. Motivet përsëriten për kohën e caktuar.


3 Për ta fikur projektoren, shtypni përsëri butonin e ndezjes/fikjes së projektorit.

Thirrja për njësinë e prindit

Nëse e keni humbur njësinë e prindit, mund të përdorni butonin FIND (Gjeni) në njësinë e bebes për të gjetur vendndodhjen e njësisë së prindit. Ky funksion punon vetëm kur njësia e prindit është e ndezur.

1 Shtypni FIND (Gjeni) në njësinë e bebes. Njësia e prindit lëshon një ton sinjalizimi për thirrjen.

2 Për të ndaluar tonin e sinjalizimit për thirrjen, shtypni përsëri FIND (Gjeni) në njësinë e bebes ose shtypni çdo buton në njësinë e prindit. Tonic i sinjalizimit për thirrjen ndalon automatikisht pas 2 minutash.



Drita e statusit të baterisë

1 Drita e statusit të baterisë është jeshile e plotë kur njësia e bebes punon me bateri dhe bateritë kanë energji të mjaftueshme.


2 Drita e statusit të baterisë pulson me shpejtësi në ngjyrë të kuqe kur bateritë janë në nivel të ulët kur njësia e bebes punon me bateri. Ndërroni bateritë kur janë në nivel të ulët.

Funksionet dhe reagimet në njësinë e prindit


Menyja e qetësimit

Njësia e prindit ka një meny të veçantë për qetësimin për të gjitha veçoritë e qetësimit: drita e natës, ninulla dhe projektori. Për të hapur menyën e qetësimit, shtypni butonin e qetësimit. Ky ekran ju lejon të përdorni në largësi dritën e natës, ninullat dhe projektoren në njësinë e babes.


1 Për të hapur menyën e qetësimit, shtypni butonin e qetësimit.




2 Përdorni butonat + dhe - për të drejtuar shigjetën te një veçori qetësimi.



3 Për të aktivizuar një veçori qetësimi kur është joaktive ose për ta çaktivizuar kur është aktive, shtypni OK. Kur veçoria është aktive, mbi simbolin e veçorisë është një shenjë zgjedhjeje. Kur veçoria është joaktive, mbi simbolin e veçorisë është një kryq.



4 Për ta hapur menyën me opsionet për veçorinë, lëvizni shigjetën mbi fushën e opsioneve dhe shtypni OK. Përdorni butonat - dhe + për të zgjedhur njësitë në fushën e opsioneve.




5 Për t'u larguar nga menyja e qetësimit, shtypni butonin e qetësimit.


Drita e natës


Kjo veçori qetësimi ju lejon të aktivizoni ose të çaktivizoni dritën e natës dhe të caktoni kohëmatësin e dritës së natës.

- 1 Zgjidhni veçorinë e dritës së natës dhe hapni menyën me opsionet e dritës së natës.



- 2 Mund ta caktoni kohëmatësin e dritës së natës për 5 deri në 20 minuta ose mund ta aktivizoni dritën e natës në vazhdimësi. Shtypni OK për ta konfirmuar. Simboli i dritës së natës shfaqet në ekran.


Nëse caktoni kohëmatësin e dritës së natës, drita e natës fiket automatikisht. Nëse e aktivizoni dritën e natës në vazhdimësi, fikeni atë në menyën e qetësimit ose duke shtypur butonin  në njësinë e bebes.




Ninulla

Kjo veçori qetësimi ju lejon të zgjidhni opsionet e luajtjes së ninullës dhe të caktoni kohëmatësin e ninullës.


- 1 Zgjidhni veçorinë e ninullës dhe hapni menyën me opsionet e ninullës.
- 2 Në menyën e opsioneve të ninullës, mund të zgjidhni një ninullë nga lista e ninullave të ruajtura paraprakisht. Mund të zgjidhni po ashtu "Play all" (Luani të gjitha) për të luajtur të gjitha ninullat e ruajtura paraprakisht.
- 3 Mund ta caktoni kohëmatësin e ninullës për 5 deri në 20 minuta ose mund të zgjidhni t'i luani ninullat në vazhdimësi. Shtypni OK për ta konfirmuar cilësimin e kohëmatësit. Simboli i ninullës dhe ninulla e luajtur shfaqen në ekran.

Nëse caktoni kohëmatësin, funksioni i ninullës çaktivizohet pas kohës së caktuar. Nëse zgjidhni t'i luani në vazhdimësi, çaktivizojeni funksionin e ninullës në menyën e qetësimit ose duke shtypur butonin  në njësinë e bebes.



Projektori

Kjo veçori qetësimi ju lejon të aktivizoni projektorin në njësinë e babes dhe të programoni kohëzgjatjen e projektimit.



- 1 Zgjidhni veçorinë e projektorit dhe hapni menyën me opsionet e projektorit.
- 2 Për t'u qasur tek opsionet e projektorit, drejtojeni shigjetën te fusha e opsioneve dhe shtypni OK.



- 3 Mund ta caktoni kohëmatësin e projektorit për 5 deri në 20 minuta ose mund ta aktivizoni projektorin në vazhdimësi. Shtypni OK për ta konfirmuar. Simboli i projektorit shfaqet në ekran.
Nëse caktoni kohëmatësin e projektorit, projektori fiket automatikisht. Nëse e aktivizoni projektorin në vazhdimësi, fiken projektorin në menyën e qetësimit ose duke shtypur butonin e projektorit në njësinë e babes.

Volumi

Volumi mund të caktohet nëse menyja nuk është aktive. Janë shtatë nivele të volumit dhe një cilësim "volume off" (volumi joaktiv).

Caktimi i nivelit të volumit

- 1 Shtypni një herë butonin + ose -.
Niveli aktual i volumit shfaqet në ekran.
- 2 Shtypni butonin + për të rritur volumin ose shtypni butonin - për të ulur volumin.
Nëse nuk shtypet asnjë buton për më shumë se 2 sekonda, treguesi i nivelit të volumit zhduket nga ekranin dhe cilësimi i volumit ruhet.

Volumi joaktiv


Nën cilësimin e volumit më të ulët, është një cilësim "volume off" (volumi joaktiv).

- 1 Shtypni një herë butonin + ose -.
Niveli aktual i volumit shfaqet në ekran.
- 2 Mbani të shtypur butonin - për më shumë se 2 sekonda për ta caktuar volumin si joaktiv.



Në ekran shfaqen mesazhi "MUTE" (Çaktivizoni zërin) dhe simboli i çaktivizimit të zërit. Shfaqen vetëm dritat e nivelit të tingujve që bebe lëshon tinguj.

Funksioni i të folurës




- 1 Nëse dëshironi ta qetësoni beben tuaj, shtypni TALK (Flisni) në njësinë e prindit dhe flisni qartë në mikrofonin në pjesën përpara nga një distancë 15-30 cm (0,5-1 ft).

Shënim: Nëse e keni caktuar volumin e ninullës më të lartë në njësinë e bebes, tingulli do të jetë po ashtu më i lartë kur përdorni funksionin e të folurës në njësinë e prindit.

- 2 Lëshoni butonin TALK (Flisni) kur të keni përfunduar së foluri.

Modaliteti i errësimit për natën



Në modalitetin e errësimit për natën, ulet intensiteti i dritës për dritat dhe ekranin dhe ulet volumi i tingujve të sinjalizimit.

- 1 Shtypni butonin e errësimit për natën për të aktivizuar modalitetin e errësimit për natën.
- 2 Shtypni përsëri butonin e errësimit për natën për t'u kthyer te modaliteti i funksionimit normal.

Sinjalizimi i nivelit të ulët të baterisë së njësisë së bebes

- 1 Kur njësia e bebes punon me bateri dhe bateritë janë në nivel të ulët, njësia e prindit lëshon sinjale bip dhe në ekran shfaqet teksti "Baby unit Change batteries" (Ndryshoni bateritë e njësisë së bebes).
- 2 Nëse nuk i ndërroni bateritë në kohë, do të humbisni lidhjen me njësinë e bebes.


Treguesit e gjendjes së baterisë

Bateria e shkarkuar

Kur bateritë e rikarikueshme janë në nivel të ulët, në ekran shfaqet "BATTERY LOW" (Nivel i ulët i baterisë), treguesi i statusit të saj është bosh dhe pulson dhe njësia e prindit lëshon sinjale bip. Koha e mbetur e funksionimit është të paktën 30 minuta.

Bateria e rënë

- 1 Nëse bateritë e rikarikueshme janë thuasje të boshatisura, drita e statusit të baterisë vezullon në ngjyrë të kuqe me shpejtësi.
- 2 Nëse nuk e lidhni njësinë e prindit me rrjetin kryesor elektrik, ajo do të fiket.




Menyja e njësisë së prindit


Navigimi në meny


Shënim: Disa funksione të menysë funksionojnë vetëm kur njësia e bebes dhe njësia e prindit janë të lidhura.

- 1 Shtypni butonin MENU (Menyja) për të hapur menyne dhe për të bërë të shfaqet opsioni i parë së menysë.



- 2 Përdorni butonin + për të shkuar tek opsioni tjetër ose butonin - për të shkuar tek opsioni i mëparshëm. Shigjeta në ekran tregon se në cilin drejtim mund të navigoni.





3 Shtypni OK për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.

Shënim: Shtypni butonin MENU (Menyja) nëse dëshironi të largoheni nga menyja pa bërë asnjë ndryshim. Nëse nuk ka asnjë hyrje në meny për më shumë se 20 sekonda, menyja mbyllet automatikisht.

Ndjeshmëria

Ky opsion në menynë e njësise së prindit ju lejon të caktoni ndjeshmërinë e mikrofonit të njësise së bebes.

Ndjeshmëria e mikrofonit përcakton se çfarë niveli zhurme kap njësia e bebes, p.sh. do të dëshironi të dëgjoni kur qan bebja.

- 1 Zgjidhni "Sensitivity" në meny me butonat + dhe - dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Përdorni butonat + dhe - për të rritur ose ulur ndjeshmërinë e mikrofonit. Numri i segmenteve të mbushura tregon nivelin e zgjedhur të ndjeshmërisë. Shtypni OK për ta konfirmuar cilësimin.

Nivelet dhe treguesit e ndjeshmërisë

Ikona	Ndjeshmëria	Përshkrimi
	më e larta	Dëgjoni gjithçka nga bebja. Altoparlanti i njësise së prindit është vazhdimisht aktiv.
	e lartë	Dëgjon të gjithë tingujt nga belbëzimet e ulëta dhe më të larta. Nëse bebja nuk lëshon asnjë tingull, altoparlanti i njësise së prindit është joaktiv.
	mesatare	Dëgjon tingujt nga të qarat e ulëta dhe më të larta. Nëse bebja lëshon tingull më të ulët, altoparlanti i njësise së prindit nuk aktivizohet.
	e ulët	Altoparlanti i njësise së prindit aktivizohet vetëm nëse bebja lëshon tinguj të lartë, për shembull, sepse po qan.

Modaliteti Eco Max

Veçoria inteligjente Eco është një veçori standarde në këtë monitor bebeje. Ai zvogëlon automatikisht sinjalin DECT nga njësia e bebes për të kursyer energjinë. Për të kursyer edhe më shumë energji, aktivizoni modalitetin Eco Max. Në këtë modalitet, sinjali DECT i njësisë së bebes çaktivizohet për sa kohë që bebja nuk lëshon asnjë tingull.

Kujdes: Në modalitetin Eco Max, njësia e prindit i merr reagimet nga njësia e bebes me një vonesë. Kur bebja lëshon një tingull, njësia e bebes në fillim duhet të riaktivizojë radiotransmetimin para se të mund të dërgojë reagime te njësia e prindit.

Kini parasysh sa më poshtë:

- Në modalitetin Eco Max nuk merrni reagime kur njësia e prindit është jashtë rrezes së njësisë së bebes. Mund ta kontrolloni lidhjen duke shtypur një buton në njësinë e prindit.
- Modaliteti Eco Max nuk mund të aktivizohet nëse ndjeshmëria e mikrofonit është caktuar në nivelin më të lartë.

Aktivizimi i modalitetit Eco Max

- 1 Zgjidhni "Eco Max" në meny me butonat + dhe - dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Kur në ekran të shfaqet "Turn On" (Aktivizoni), shtypni OK për të aktivizuar modalitetin Eco Max.
- 3 Në ekran shfaqet mesazhi paralajmërues "No alert if out of range, OK?" (Nuk ka sinjalizim nëse jeni jashtë rrezes. Në rregull?). Shtypni OK për ta konfirmuar.

Shënim: Mesazhi paralajmërues lëviz dy herë përgjatë ekranit. Nëse nuk shtypni OK, njësia e prindit largohet nga menya dhe modaliteti Eco Max qëndron joaktiv.

- 4 Treguesi Eco Max pulson në ekran. Drita te "link" (lidhja) pulson ngadalë në ngjyrë jeshile kur njësia e bebes nuk transmeton asnjë sinjal te njësia e prindit.
- 5 Kur njësia e prindit merr një sinjal nga njësia e bebes pasi është riaktivizuar radiotransmetimi, drita te "link" (lidhja) bëhet ngjyrë jeshile e fortë.




Çaktivizimi i modalitetit Eco Max

- 1 Shtypni butonin MENU (Menyja).
- 2 Përdorni butonat + dhe - për të zgjedhur „Eco Max“ dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 3 Kur në ekran të shfaqet “Turn Off” (Çaktivizoni), shtypni OK për ta konfirmuar.

Kohëmatësi i ushqimit

Mund të caktoni kohëmatësin e ushqimit për t'ju sinjalizuar se është koha për të ushqyer beben. Kohëmatësi mund të caktohet nga 1 minutë deri në 23 orë e 59 minuta.

- 1 Për të hapur nënmenynë e kohëmatësit të ushqimit, zgjidhni "Feed Timer" (Kohëmatësi i ushqimit) në meny. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Zgjidhni "Feed Timer" (Kohëmatësi i ushqimit) në nënmenynë e kohëmatësit të ushqimit. Shtypni OK për të filluar të cilësoni kohëmatësin.
- 3 Caktoni orën dhe minutat dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 4 Për të nisur kohëmatësin e ushqimit, zgjidhni "xx:xx Start" në nënmenynë e kohëmatësit të ushqimit. Shtypni OK për ta konfirmuar. Simboli i kohëmatësit shfaqet në ekran dhe kohëmatësi fillon numërimin mbrapsht.



- 5 Kur kohëmatësi të ketë arritur 00:00, dëgjohet sinjalizimi i kohëmatësit të ushqimit, simboli i kohëmatësit fillon të pulsojë në ekran dhe përgjatë ekranit lëviz mesazhi "TIMER END" (Fundi i kohëmatësit).
- 6 Për të ndaluar kohëmatësin, zgjidhni "Stop & Reset" në nënmenynë e kohëmatësit të ushqimit dhe shtypni OK për ta konfirmuar.

Caktimi i përsëritjes së kohëmatësit të ushqimit

- 1 Për të bërë që alarmi i kohëmatësit të ushqimit të bjerë në të njëjtën kohë të caktuar, zgjidhni „Timer repeat“ (Përsëritja e kohëmatësit) në nënmenynë e kohëmatësit të furnizimit pasi ta kenë caktuar kohëmatësin. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Zgjidhni „Repeat ON“ (Përsëritja aktive) ose „Repeat OFF“ (Përsëritja joaktive) dhe shtypni OK për ta konfirmuar. Simboli i përsëritjes së kohëmatësit shfaqet në ekran.
- 3 Nëse caktoni „Repeat ON“ (Përsëritja aktive), kohëmatësi i furnizimit fillon përsëri numërimin mbrapsht pasi ta ndaloni sinjalizimin.

Caktimi i një sinjalizimi të kohëmatësit të ushqimit


- 1 Për të caktuar një sinjalizim, zgjidhni „Timer Alert“ (Sinjalizimi i kohëmatësit) në nënmenynë e kohëmatësit të ushqimit. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Zgjidhni një nga opsionet e sinjalizimit. Opsionet e disponueshme janë vetëm tingujt, tingujt dhe dridhjet dhe vetëm dridhjet.
- 3 Shtypni çdo buton për të ndaluar sinjalizimin ose sinjalizimi ndalon automatikisht pas 2 minutash.
- 4 Për të ndaluar kohëmatësin, zgjidhni „Stop & Reset“ në nënmenynë e kohëmatësit të ushqimit dhe shtypni OK për ta konfirmuar.

Temperatura e dhomës

Një bebe fle qetë në një temperaturë nga 16°C/61°F deri në 20°C/68°F. Mund të caktoni një gamë të temperaturës minimale dhe maksimale dhe një sinjalizim.

- 1 Për të hapur nënmenynë e temperaturës, zgjidhni "Temperature" (Temperatura) në meny. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Zgjidhni "Temp Range" (Gama e temperaturës) në nënmenynë e temperaturës dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 3 Përdorni butonat + dhe - për të caktuar gamën e temperaturës minimale nga 10°C/50°F dhe 19°C/66°F dhe gamën e temperaturës maksimale nga 22°C/72°F deri në 37°C/99°F. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 4 Zgjidhni "Alert" (Sinjalizimi) në nënmenynë e temperaturës. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 5 Zgjidhni një nga opsionet e sinjalizimit. Opsionet e disponueshme janë vetëm tingujt, tingujt dhe dridhjet, vetëm dridhjet dhe vetëm ekрани. Shtypni OK për ta konfirmuar. Simboli i sinjalizimit të temperaturës shfaqet në ekran.
- 6 Zgjidhni "Temp Scale" (Shkalla e temperaturës) në nënmenynë e temperaturës. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 7 Zgjidhni "Celsius" ose "Fahrenheit" dhe shtypni OK për ta konfirmuar. Në ekran shfaqet temperatura në shkallën e caktuar. Nëse temperatura është brenda gamës së caktuar, simboli i sinjalizimit të temperaturës ka dy segmente.

Nëse temperatura është nën ose mbi gamën e caktuar, simboli i sinjalizimit të temperaturës në ekran ka vetëm një segment dhe pulson. Mesazhi "TOO COLD" (Shumë ftohtë) ose "TOO HOT" (Shumë nxehtë) shfaqet në ekran.



Sinjalizimi për të qarat



Mund të caktoni një sinjalizim për të qarat që t'ju njoftojë se bebja po qan.

- 1 Zgjidhni "Cry alert" (Sinjalizimi për të qarat) në meny me butonat + dhe -. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Kur në ekran të shfaqet "Vibration ON" (Dridhjet aktive), shtypni OK për ta konfirmuar. Treguesi i sinjalizimit për të qarat shfaqet në ekran. Sinjalizimi për të qarat aktivizohet kur tingulli në dhomën e bebes është mjaft i lartë për të aktivizuar nivelin e katërt të tingujve. Njësia e prindit lëshon dridhje dhe në ekran shfaqet mesazhi "Cry alert" (Sinjalizimi për të qarat) për 4 sekonda. Sinjalizimi për të qarat përsëritet çdo 8 sekonda deri sa tingulli të jetë më i ulët ose ta çaktivizoni sinjalizimin për të qarat.
- 3 Për të çaktivizuar sinjalizimin për të qarat, zgjidhni "Cry alert" (Sinjalizimi për të qarat) në meny. Kur në ekran të shfaqet "Vibration OFF" (Dridhjet joaktive), shtypni OK për ta konfirmuar.

Ora

Cilësimi i parazgjedhur për orën është i fshehur. Mund të zgjidhni që ta shfaqni orën dhe ta caktoni orën në meny e njësive të prindit.

- 1 Zgjidhni "Set clock" (Caktoni orën) në meny me butonat + dhe -. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Zgjidhni "Show Time" (Shfaqni orën) dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 3 Zgjidhni "Set the time" (Caktoni orën) dhe shtypni OK për ta konfirmuar.
- 4 Caktoni orën dhe minutat dhe shtypni OK për ta konfirmuar. Ora alternohet me treguesit e tjerë në fushën e mesazheve të ekranit.

Gjuha

Mund të përdorni këtë opsion të menysë për të ndryshuar cilësimin e gjuhës.

- 1 Zgjidhni "Set language" (Caktoni gjuhën) në meny me butonat + dhe -. Shtypni OK për ta konfirmuar.
- 2 Përdorni butonat + dhe - për të zgjedhur gjuhën tuaj dhe shtypni OK për ta konfirmuar.

Kyçja e butonave

Mund të aktivizoni kyçjen e butonave për të parandaluar shtypjen aksidentale të butonave kur lëvizni me njësinë e prindit.

- 1 Për të aktivizuar kyçjen e butonave, shtypni OK.
- 2 Shtypni butonin + brenda 2 sekondave.

Shënim: Nëse nuk e shtypni butonin + brenda 2 sekondave, udhëzimet do të qëndrojnë në ekran.

- 3 Pasi të keni shtypur butonin +, në ekran shfaqet mesazhi "Keys locked".
- 4 Për të çaktivizuar kyçjen e butonave, shtypni OK. Kur në ekran shfaqet mesazhi i udhëzimeve, shtypni butonin + brenda 2 sekondave.

Shënime:

- Kur shtypni një buton të ndryshëm nga butoni OK kur kyçja e butonave është aktive, ekрани aktivizohet dhe rreshti i dytë i ekranit ju tregon se si ta çaktivizoni kyçjen e butonave.
- Kur shtypni butonin OK kur kyçja e butonave është aktive, rreshti i dytë i ekranit ju tregon se cili është hapi i dytë i nevojshëm për shkyçjen e butonave.



Informacione mjedisore

Janë hequr të gjitha paketimet e panevojshme. Kemi provuar ta bëjmë paketimin më të lehtë për t'u ndarë në dy materiale: karton kuti dhe polietilen (qese, fletë mbrojtëse prej sfungjeri).

Riciklimi



Ky simbol do të thotë që produktet elektrike dhe bateritë nuk duhet të hidhen me mbeturinat normale të shtëpisë.

Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçar të produkteve elektrike dhe baterive.

Mbështetja

Për mbështetje për të gjitha produktet, si pyetjet më të shpeshta, vizitoni www.philips.com/support.

SCD730/SCD731/SCD733/SCD734/SCD735 (EN)




< Sensitivity >	OK		OK
< Eco Max >	OK	Turn On? > < Turn Off?	!No alert if... OK
< CryAlert >	OK	Vibrate On? > < Vibrate Off?	
< FeedTimer >	OK	xxxx Start? >	
	< Set Timer >	Hr 00:00	00:30 Min
	< Timer Repeat >	Repeat ON > < Repeat OFF	
	< Timer Alert >	Sound only > < Sound & Vibe > < Vibrate only	
< Temperature >	OK	Temp Range >	Minimum XX°C OK Maximum YY°C OK
	< Temp Alert >	Sound only > < Sound & Vibe > < Vibrate only > < Screen only > < Off	
	< Temp Scale >	Celsius > < Fahrenheit	
< Set Clock >	OK	Show/Hide >	Hide Clock > < Show Clock
	< Set The Time >	Hr 00:00	00:00 Min
< Set Language >	OK	English > ... < Русский	

Press OK =

< =

> =



 Light Timer	OK	5 minutes > < 10 minutes > < 15 minutes > < 20 minutes > < Continuous	OK
 Lullaby	OK	Play no.1 > < Play no.12 > < > < Play all >	OK
 Proj. timer	OK	5 minutes > < 10 minutes > < 15 minutes > < 20 minutes > < Continuous	OK
Song Timer	OK	5 minutes > < 10 minutes > < 15 minutes > < 20 minutes > < Continuous	OK

Press OK = 

< = 

> = 

